



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:128683

Datë: 22.02.2023

Numri i dokumentit: 04003101

**PKR.nr.172/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**-Departamenti për Krime të Rënda, me Kryetarin e trupit gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale ndaj të pandehurit B. N. për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.158/22 të dt. 09.09.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 20.02.2023, në prezencë të Prokurorit të shtetit Ersan Qavolli, të pandehurit B. N. dhe mbrojtësit të tij av. D. K. sipas autorizimit, në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.22.02.2023 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri

**B. N.**, i biri i D. dhe nënës L., e gjinisë D., i lindur me dt. ...., në Gj., me vendbanim në Gj., rr. “.....”, p.nr., ka të kryer shkollën fillore, me l.nj.nr....., me profesion kamarier, i pamartuar, posedues i nr. tel....., i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Më dt. 13.03.2022 rreth orës 13:10 ne fsh. .... K. K., pa autorizim posedon substancë narkotike të llojit marihuanë ne atë mënyrë qe gjatë patrullimit të policisë në fshatin K., hasin në automjetin e llojit “A. Q.” me targa ....., pronë e te pandehurit e cila ishte e ndaluar buze rrugës, e në të cilin ishte i pandehuri dhe dëshmitarët: D. P., A. S. dhe A. S., ashtu që gjatë legjitimitetit të tyre në një nga xhepat e jaknës së të pandehurit e cila ishte e vendosur në ulësen e shoferit është gjetur dhe konfiskuar një mulli për bluarjen e narkotikeve dhe sasia e substancës narkotike e cila pas ekzaminimit ka rezultuar të jetë e llojit marihuanë me peshë neto prej 4,7 gram,

- me çka ka kryer veprë penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7, 38, 39, 40, 43, 46 par. 1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, nenit 269 par. 1 dhe 269 par. 3 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPRK-së, të pandehurin e:

## **G J Y K O N**

### **DËNIM ME GJOBË DHE DËNIM ME KUSHT**

Ashtu që të pandehurit të lartcekur i përcaktohet

- **I. DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 500 (pesëqind )euro, e të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 (tre) muajve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit
- **II. DËNIM ME KUSHT** duke ia shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbaj nëse në afat prej **1 (një) viti**, nuk do të kryej veprë tjetër penale.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I pandehuri obligohet që në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të pandehurit i konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë neto prej 4,7 gram.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të rënda ka ngrit aktakuzë PP/I.nr. 158/22 të dt. 09.09.2022, ndaj të pandehurit B. N. për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Me dt. 20.02.2023, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar dhe prezentë kanë qenë, Prokurori i Shtetit, Ersan Qavolli, i pandehuri B. N. dhe mbrojtësit i tij av. D. K. sipas autorizimit.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par. 1 të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta dhe se për mbrojtës ka angazhuar av. D. K. sipas autorizimit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i Shtetit, kryetari i trupit gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri, e ka pranuar fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht, ka shtuar se ndihet i penduar dhe ka premtuar se më nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Mbrojtësi i të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, pas konsultimit të mjaftueshëm me atë si mbrojtës, i njëjti e ka bërë pranimin e plotë të fajësisë me vet dëshirë dhe pa kurrfarë presioni duke kuptuar privilegjet dhe pasojat që rrjedhin nga pranimi i fajësisë, duke shpreh keqardhje të thellë dhe të sinqertë.

Prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës.

Kryetari i Trupit Gjykues është i bindur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 241 dhe 242 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: Raportet e hetuesit A. K. #....., të përpiluara nën nr. të rastit: ....-.-...., dt. 13.03.2022; Deklarata e të pandehurit B. N., e dhënë pranë Stacionit Policor - Njësitit të Hetimeve - K., dt. 13.03.2022; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i përpiluar nën nr. të rastit: ....-.-...., dt. 13.03.2022; Fotografitë e substancës narkotike dhe fotografitë nga vendi i ngjarjes; Deklarata e dëshmitarit D. P., e dhënë pranë Stacionit Policor - Njësitit të Hetimeve - K., dt. 13.03.2022; Deklarata e dëshmitares A. S., e dhënë pranë Stacionit Policor - Njësitit të Hetimeve - K., dt. 13.03.2022; Deklarata e dëshmitares A. S., e dhënë pranë Stacionit Policor - Njësitit të Hetimeve - K., dt. 13.03.2022; Raporti i analizës së narkotikeve, i përpiluar nën nr. të rastit: ....-.-... i dt. 13.04.2022 dhe fotografitë mbi matjen e substancës narkotike, deklarata e të pandehurit B. N., e dhënë në Prokurori me dt. 25.08.2022 si dhe shkresat e tjera të lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 242 par 6 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit B. N. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i parket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit, gjykata mori pranimin e fajësisë, pendimin për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, faktin se i pandehuri me parë nuk ka qenë i dënuar për vepra tjera penale dhe është hera e parë që bije ndesh me ligjin, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti..

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Kryetari i Trupit Gjykses, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 50 euro, duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.2 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 269 par.3 të KPRK-së, konfiskohen substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë neto prej 4,7 gram.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.172/22, dt. 22.02.2023**

**Bashkëpunëtore profesionale**  
Selvane Bukleta

**Kryetari i trupit gjykses-gjyqtari**  
Shaqë Curri

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.